



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI



GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Shërbimi i seancës plenare

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____/____/2026

Lënda: Depozitim projektligji.

Drejtuar: Z. Niko PELESHI

KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

I nderuar z. Kryetar,

Bazuar në nenin 78, 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 68, të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqes për shqyrtim dhe miratim **projektligjin** “Për një shtesë në ligjin nr. 9710, datë 10.4.2007 ‘Për portet turistike në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar”.

Ju faleminderit.

DEPUTETI PROPOZUES

*Zemita Simaj
anniso*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2026

PËR

**NJË SHITESË NË LIGJIN NR.9710, DATË 10.4.2007, “PËR PORTET
TURISTIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim deputeti,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9710, datë 10.4.2007, “Për portet turistike në Republikën e Shqipërisë propozohet shtesa si më poshtë:

Neni 1

Pas paragrafit të parë të nenit 6, të ligjit nr.9710, datë 10.4.2007, “Për portet turistike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shtohet një paragraf më këtë përmbajtje:

“Kur një subjekti i është dhënë “Statusi “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë”, nga Komiteti i Investimeve Strategjike, dhe njëkohësisht porti/et turistik/e janë pjesë përbërëse e një investimi strategjik, të miratuar nga KIS, ndërtimi dhe operimi i portit/eve turistik/e përjashtohet nga parashikimi i paragrafit të parë, të këtij neni. Ndërtimi dhe operimi i portit/eve turistik/e kryhet nga subjekti që i është dhënë “Statusi “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë.

Procedurat, rregullat dhe dokumentacioni i nevojshëm për lidhjen e kontratës për ndërtimin dhe operimin e portit/eve turistik/e, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI

RELACION SHPJEGUES

PROJEKTLIGJI “PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 9710, DATË 10.4.2007 ‘PËR PORTET TURISTIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË’, I NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji ka për qëllim propozimin e një shitesë në ligjin nr. 9710, datë 10.4.2007, “Për portet turistike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me synim harmonizimin e dispozitave të këtij ligji me legjislacionin për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë. Ligji nr. 9710/2007 parashikon si rregull të përgjithshëm realizimin e porteve turistike përmes procedurave konkurruese dhe koncesionare, ndërsa ligji për investimet strategjike përcakton procedura të posaçme administrative për projektet që klasifikohen si strategjike dhe që konsiderohen me interes publik.

Në praktikë, kur portet turistike janë pjesë përbërëse e investimeve strategjike turistike, zbatimi paralel i këtyre dy kuadrove ligjore sjell mbivendosje procedurash dhe vështirësi në realizimin e projekteve. Përmes këtij projektligji synohet krijimi i një trajtimi të veçantë për këto raste, me qëllim garantimin e unitetit të projektit strategjik, përshpejtimin e proceseve administrative dhe rritjen e sigurisë juridike.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK DHE DOKUMENTE STRATEGJIKE

Projektligji nuk është parashikuar në planin analitik të projektakteve për vitin 2026, megjithatë ai përputhet me objektivat e politikave shtetërore për zhvillimin e turizmit, promovimin e investimeve strategjike dhe përmirësimin e klimës së biznesit. Ndryshimi i propozuar mbështet politikat për zhvillimin e turizmit elitare dhe për rritjen e rolit të investimeve me ndikim të lartë ekonomik dhe social, në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit dhe integritet evropian.

III. ARGUMENTIMI NË RAPORT ME PROBLEMATIKAT, PËRPARËSITË DHE EFEKTET E PRITSHME

Sipas ligjit nr. 9710/2007, ndërtimi dhe operimi i porteve turistike realizohet, si rregull, nëpërmjet procedurave të dhënies me koncesion ose formave të tjera konkurruese. Nga ana tjetër, ligji për investimet strategjike parashikon procedura të asistuar dhe të veçanta, të cilat synojnë përshejtimin e realizimit të projekteve me interes publik.

Në rastet kur portet turistike janë pjesë integrale e projekteve strategjike turistike, këto dy sisteme procedurale kanë krijuar mbivendosje, vonesa administrative dhe paqartësi kompetencash, duke ndikuar në ecurinë e investimeve.

Projektligji synon të adresojë këtë problematikë duke përcaktuar se, në rastet e investimeve strategjike të miratuara nga Komiteti i Investimeve Strategjike, ndërtimi dhe operimi i porteve turistike realizohet nga vetë subjekti që ka përfituar statusin strategjik, pa iu nënshtruar procedurës së përgjithshme koncesionare.

Ky rregullim garanton unitetin e projektit investues dhe mundëson zbatimin e plotë të procedurave të posaçme të parashikuara nga ligji për investimet strategjike.

Efektet e pritshme nga miratimi i projektligjit lidhen me përshejtimin e realizimit të projekteve strategjike turistike, rritjen e investimeve në sektor, krijimin e vendeve të reja të punës, zhvillimin e qëndrueshëm rajonal dhe përmirësimin e konkurrueshmërisë së turizmit shqiptar.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMIT ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Projektvendimi mbështetet në nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe është në përputhje me parimet e ligjshmërisë, dhe hierarkisë së akteve normative. Ndryshimi i propozuar harmonizohet me dispozitat e ligjit nr. 9710/2007 dhe me ligjin për investimet strategjike, duke respektuar kompetencat e Komitetit të Investimeve Strategjike, rolin e Agjencisë

Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve dhe parimet e procedurave të posaçme administrative. Dispozitat e reja nuk cenojnë parimet kushtetuese dhe garantojnë koherencën e sistemit normativ.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Projektakti nuk synon përafrim të drejtpërdrejtë me *acquis communautaire*

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon shtimin e një paragrafi të ri në nenin 6 të ligjit nr. 9710/2007, me anë të të cilit përcaktohet se, kur një subjekt ka përfituar statusin “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë” dhe porti ose portet turistike janë pjesë përbërëse e një investimi strategjik të miratuar nga Komiteti i Investimeve Strategjike, ndërtimi dhe operimi i tyre përjashtohet nga procedura e përgjithshme e koncesionit dhe realizohet nga vetë subjekti investues. Gjithashtu, parashikohet që procedurat, rregullat dhe dokumentacioni për lidhjen e kontratës përkatëse të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e projektaktit ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, ministria përgjegjëse për Turizmin, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, Komiteti i Investimeve Strategjike dhe institucionet e tjera përgjegjëse sipas fushës së kompetencave.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektakti nuk sjell efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit, pasi zbatimi i tij realizohet nëpërmjet strukturave dhe burimeve ekzistuese institucionale. Përkundrazi, pritet që ai të kontribuojë në rritjen e investimeve, zgjerimin e bazës tatimore dhe forcimin e zhvillimit ekonomik afatgjatë.